



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 75 prot.

Kamëz, më 18.6.2021

V E N D I M

Nr. 61 .Datë 18 / 6 2021

MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORËT SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **18.06.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Nr.52 Datë 16.06.2021** mbështetur në Ligjin 57,datë 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM nr.956, datë 07.12.2016 “Përpërcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore”; Kreun IV, pika 2, të Vendimit nr.955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar; Udhëzimit nr.5, date 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri ne 6%”, të ndryshuar; Kreun IV,pika 3,tëVKM nr. 597 datë 04.09.2019“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmë ekonomike”. dhe në VKB nr 158 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së **muajit MAJ 2021, prej 58 familjeve** që janë rekomanduar nga administrator shoqërorë, për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
Fondi për këto familje është **388,360 (treqind e tetëdhjetë e tetëmijë e treqinde gjashtëdhjetë)** lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi, paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/ Kryetar Këshilli

